



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ex officio
Rasti nr. 489 /2018

në lidhje me
përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët

Për:

- Z. Uran Ismaili
Ministria e Shëndetësisë

- Z. Rashit Qalaj, Drejtor i Përgjithshëm
Policia e Kosovës

- Z. Skender Reçica, Ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Z. Shyqiri Bytyçi, Ministër
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

- Z. Skender Çoçaj, Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

- Z. Bahri Hyseni, Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës

Prishtinë, më 16 dhjetor 2019

Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i gjendjes aktuale rreth përdorimit të substancave narkotike nga fëmijët dhe adresimi i rekomandimeve tek institucionet përkatëse në mënyrë që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme në parandalimin dhe trajtimin e fëmijëve përdorues të substancave narkotike.

Baza ligjore

1. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta)¹ dhe Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 16/26 qershor 2015, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit)², i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 1.1 “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.” (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës).
- 1.2 “Avokati i Popullit mund të jap rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.” (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës).
- 1.3 “(...) me iniciativën e vet (*ex officio*)..... nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.” (neni 16, paragrafi 4, i Ligji për Avokatin e Popullit)
- 1.4. “të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shpreh mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit).
- 1.5. “të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit;” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Ligji për Avokatin e Popullit).
- 1.6. “t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit).

Avokati i Popullit e dërgon këtë raport tek institucionet kompetente si dhe e publikon atë në ueb-faqen e tij, në mënyrë që të evitohen shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe të respektohen ligjet në fuqi në pajtim me parimin e sundimit të ligjit.

Faktet

2. Më 19 korrik 2018, Avokati i Popullit ka iniciuar hetime sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) duke u bazuar në nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit për Avokatin e Popullit.
3. Më 8 mars 2018, përfaqësuesit e IAP-së janë takuar me përfaqësuesin e OJQ-së “Labirinth” për të diskutuar lidhur me përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>

4. Gjatë vitit 2018, përfaqësuesit e IAP-së janë takuar me përfaqësuesit e Koalicionit të Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) për të diskutuar lidhur me përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët.
5. Më 8 mars 2018, IAP-ja është njoftuar me shkrim nga OJQ Labirinthe lidhur me të dhënat mbi konsumimin e substancave narkotike nga fëmijët.
6. Më 28 gusht 2018, përfaqësuesi i IAP-së është takuar me përfaqësuesin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) për t'u informuar lidhur me aktivitetet që kjo ministri i ka ndërmarrë për vetëdijesimin e të rinjve për rreziqet dhe për pasojat e përdorimit të substancave narkotike nga të rinjtë. Përfaqësuesi i MKRS-së ka pohuar me këtë rast se kjo ministri aktivitetet e vetëdijesimit i kryen në mbështetje/përkrahje të OJQ-ve.
7. Më 14 nëntor 2018, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me përfaqësuesin e Sektorit për Bashkëpunim dhe Parandalim, të Policisë së Kosovës lidhur me çështjen.
8. Më 15 nëntor 2018, përfaqësuesi i IAP-së e ka pranuar nga përfaqësuesi i Policisë së Kosovës Raportin vjetor (tetor 2017- tetor 2018) "Stop drogës në shkolla" dhe statistikën sipas moshave, të regjistruara në Policinë e Kosovës.
9. Më 8 maj 2019, përfaqësuesi i IAP-së ka kërkuar nga përfaqësuesit e ROR-it³ që t'ia dërgojnë IAP-së pikëpamjet e grupit lidhur me çështjen e përdorimit të substancave narkotike nga fëmijët.
10. Më 20 mars 2019, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me përfaqësuesen e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT) lidhur me çështjen, veçmas për aktivitetet e ndërmarra nga MASHT-i në fushën e parandalimit.
11. Më 28 maj 2019, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me përfaqësuesin e Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht me përfaqësuesin e Klinikës Psikiatrike lidhur me çështjen.
12. Më 7 qershor 2019, përfaqësuesi i IAP-së ka kërkuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) që ta informojë për numrin e rasteve për vepra penale sipas nenit 281, lidhur me paragrafin 1.7 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kodi nr. 04/L-082): *"1.7 vepra është kryer brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga cilido institucion i edukimit"*⁴.
13. Përfaqësuesi i KPK-së në po të njëjtën ditë e ka informuar përfaqësuesin e IAP-së se Zyra për Statistika në kuadër të KPK-së nuk grumbullon dhe nuk posedon të dhëna specifike që ndërlidhen me paragrafin 1.7 të neni 281 të Kodit nr. 04/L-082, por mban të dhëna në përgjithësi për veprat penale nga Kapitulli XXIII i këtij Kodi.
14. Më 7 qershor 2019, përfaqësuesi i IAP-së ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) që ta informojë për numrin e rasteve për veprat penale sipas nenit 281 lidhur me

³ Grupi Kombëtar i Drejtuar nga Fëmijët: Respektoni të drejtat tona.

⁴ Sa është numri i kallëzimeve penale paraqitur prokurorit të shtetit nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018?; Sa është numri i hedhjes së kallëzimeve penale nga prokurori i shtetit nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018?; Sa është numri i aktvendimeve për fillimin e hetimeve nga prokurori i shtetit nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018?; Sa është numri i aktvendimeve për pushimin e hetimeve nga prokurori i shtetit nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018?; Sa është numri i aktvendimeve për pezullimin e hetimeve nga prokurori i shtetit nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018?; Sa është numri i aktakuzave të ngritura nga prokurori i shtetit nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018?

paragrafin 1.7 të Kodit nr. 04/L-082: "1.7vepra është kryer brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga cilido institucion i edukimit."⁵ Por deri në publikimin e këtij Raporti me rekomandime, nuk ka marrë përgjigje përkitazi me këtë çështje.

Gjendja lidhur me përdorimin e substancave narkotike

15. Në Kosovë deri vonë nuk ka pasur studime gjithëpërfshirëse lidhur me përdorimin e substancave narkotike, ndonëse studime të pjesshme dhe shërbime të ndryshme parandaluese e rehabilituese janë ofruar nga organizata të ndryshme joqeveritare.
16. Anketa e parë e përgjithshme e popullsisë mbi përdorimin e substancave narkotike dhe qëndrimet në Kosovë është lansuar në vitin 2014, me mbështetjen e Qendrës Evropiane Monitoruese të Narkotikëve dhe Varësisë nga Narkotikët (EMCDDA).⁶ Sipas saj, përdorimi i antidepressantëve në vitin 2013 ishte më i ulët se 1%. Një mesatare prej 2% e të anketuarve raportojnë se kanë përdorur antidepressantë në të kaluarën, por jo gjatë vitit të kaluar. Shumica e përdoruesve që kanë raportuar kanë deklaruar se kanë blerë ilaçet me recetë të mjekut, por në pak raste ilaçet janë marrë përmes rrugëve joformale.⁷ Po ashtu sipas anketës, kanabisi është substanca më e përdorur e paligjshme në Kosovë, ku 10% e të anketuarve kishin pranuar se njohin dikë që përdor kanabis. Prevalenca e raportuar e përdorimit të kanabisit, dhe substancave të tjera të paligjshme, siç janë ekstazia, amfetamina, heroina etj., është raportuar të jetë mjaft e ulët.⁸
17. Më tutje një studim tjetër më i vogël në numër është zhvilluar në vitin 2008 nga PRISM Research, Inc., me mbështetjen financiare të OBSH-së, UNICEF-it dhe UNFPA-s.⁹ Raporti i publikuar nga ky hulumtim ka paraqitur të dhënat mbi përdorimin e substancave psikoaktive në mesin e të rinjve, të burgosurve (para burgosjes) dhe përdoruesve të drogave injektuese në Kosovë. Sipas tyre, droga është në dispozicion në Kosovë dhe se të gjitha llojet e substancave psikoaktive përdoren nga rinia kosovare nga të gjitha etnitetet. Të rinjtë djem (5.5%) kishin më shumë gjasa sesa të rejat vajza (2.2%) dhe të rinjtë e moshës 20 - 24 (6.7%) kishin më shumë gjasa se adoleshentët (1.7%) ta kenë provuar kanabisin. Më pak se gjysmë për qind apo 0.4% e të rinjve nga Kosova raportuan të kenë provuar heroinë, 0,4 % amphetamine dhe vetëm 0.2% raportuan të kenë provuar ndonjëherë kokainë.¹⁰
18. Sipas të dhënave të siguruar nga OJQ Labirinthe për vitin 2017, moshë mesatare e fillimit të përdorimit të drogës ka qenë 16.06 vjeç, kryesisht këta të rinj kanë filluar me përdorimin e kanabisit. Krahasuar me vitet e kaluara, sipas përfaqësuesve të Labirinthe,

⁵ Sa është numri i aktvendimeve gjyqësore për hedhje të aktakuzës nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018? Sa është numri i aktgjykimeve liruese, refuzuese dhe fajësuese nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018?

⁶ European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction, National General Population Survey on drug use and attitudes in Kosovo* 2014 according to the EMCDDA protocols, 2014, në: <file:///C:/Users/HP/Downloads/drug-use-and-attitudes-Kosovo-EN.pdf>.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ OBSH, UNICEF, UNFPA, Përdorimi i Substancave Psikoaktive në Kosovë Vlerësimi i Shpejtë dhe Përgjigje me të Rinj, Përdorues të Drogave Injektuese, dhe të Burgosur, 2009, fq. 8, në: https://www.unicef.org/kosovoprogamme/RAR_Alb.pdf.

¹⁰ Po aty, fq. 26.

mosha e fillimit të përdorimit të drogës së parë ka rënë dukshëm, kur në 2007 ishte 21 vjeç. Prej 1205 personave të regjistruar në data bazën e Labirinthit si përdorues prej vitit 2002-2017, 85 prej tyre kanë vdekur si pasojë e ndërlydhjes me drogat, 4 prej tyre kanë qenë të moshës 20 vjeç.¹¹ Gjithashtu¹² të dhënat e siguruar nga Labirinthi për vitin 2018 tregojnë se mosha mesatare e përdorimit të kanabisit nuk ka ndryshuar as për vitin 2018. Po ashtu të dhënat tregojnë se nga janari i vitit 2018 e deri në nëntor të vitit 2018 kanë vdekur nëntë persona.

19. Sipas Indeksit për mbrojtjen e fëmijëve¹³, Kosova nuk ofron shërbime të veçanta të rehabilitimit fizik për fëmijët viktime të abuzimit me narkotikë, gjë që sipas tij rekomandohet fuqimisht që qeveria të caktojë prioritet mbrojtjen e fëmijëve viktime të abuzimit me narkotikë nëpërmjet krijimit, sponsorizimit dhe zhvillimit të shërbimeve në nivel shtetëror që mundësohet nga ofruesit shtetërorë dhe privatë. Gjithashtu, pos tjerash theksohet edhe nevoja për zhvillimin e programeve të riintegritimit në përgjigje të nevojave në rritje të fëmijëve dhe familjeve të tyre.
20. Sipas të dhënave të siguruar nga Policia e Kosovës¹⁴, prej 2 tetor 2017 deri më 31 tetor 2018, janë realizuar 36624 patrullime rreth shkollave; 19880 vizita dhe kontakte me personelin e shkollave; 385 lokale janë kontrolluar; 19214 vetura janë kontrolluar; 40530 persona janë kontrolluar; 710 persona janë arrestuar, prej tyre 150 nxënës, si dhe në shkolla janë mbajtur 417 ligjëratë. Sipas të dhënave, pos tjerash, janë konfiskuar 62.74 gr mariuhanë, brenda objekteve të shkollave, 167.15 gr mariuhanë në oborre të shkollave, 4 kg e 052 gr mariuhanë në afërsi të shkollave. Gjithashtu, sipas të dhënave të siguruar nga Policia e Kosovës, numri me i madh i rasteve është iniciuar në regjionin e Prishtinës, pastaj vjen Ferizaj, Mitrovica, Gjilani, Peja, Prizreni dhe Gjakova.
21. Sipas informatave të siguruar nga përfaqësuesja e MASHT-it del se temat për parandalimin e përdorimit të substancave narkotike, në kuadër të plan-programeve mësimore, shtjellohen në lëndën e edukatës fizike, të sporteve dhe të shëndeti, kimisë, biologjisë dhe edukatës qytetare dhe se në shkolla, në bashkëpunim me institucione të tjera, realizohen aktivitete vetëdijesimi për nxënës. Ndërsa mbetet sfiduese organizimi i takimeve me prindër, për t'i informuar ata lidhur me rolin e tyre në fushën e parandalimit të konsumimit të substancave narkotike.
22. Sipas informatave të siguruar nga KP-ja, është më se e nevojshme adoptimi i hapësirave apo ndërtimi i hapësirave të reja, siç do të ishte një qendër apo një institut i veçantë, i cili do të merrej me politikën dhe programet parandaluese, trajtuese dhe do ta kishte rolin

¹¹ Ndërsa hulumtime të tjera tregojnë se si abuzimi me alkool dhe droga është i lidhur ngushtë me abuzimin në fëmijëri (UNICEF, Hulumtimi cilësor mbi normat sociale lidhur me dhunën me bazë gjinore dhe ndëshkimin fizik të fëmijëve në Kosovë, korrik 2016). Po ashtu, Raporti i Sigurisë Njerëzore: Kosovë (publikuar në nëntor të vitit 2014 nga Qendra për hulumtim, dokumentim dhe publikim), ndër tjerash, trajton praninë e armëve dhe të drogës si një burim i pasigurisë. Sipas këtij hulumtimi, shumica e të anketuarve në diskutime të grupeve të fokusit dëshmuar se një burim i madh i pasigurisë në shkollë është mbajtja e armëve, veçanërisht thika dhe boksi i hekurit. Në disa raste, mbajtja e armëve dhe përdorimi i mariuhanës ishin të lidhura ngushtë; shumë shpesh, i njëjti grup i nxënësve manifeston të dyja sjelljet.

¹² Më 7 nëntor 2018, IAP-ja është informuar me shkrim nga OJQ Labirinthi lidhur me të dhënat për konsumimin e substancave narkotike nga fëmijët.

¹³ Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 2.0.

¹⁴ Raporti vjetor (Tetor 2017- Tetor 2018) "Stop drogës në shkolla" dhe statistikat sipas moshave, të regjistruara në Policinë e Kosovës.

koordinues si qendër referuese terciare në nivel të Kosovës. Gjithashtu, sipas informatave në fjalë del se është më se i nevojshëm edhe krijimi i kushteve dhe i hapësirave të nevojshme për hospitalizim për fëmijët me varësi nga substancat narkotike, pasi që në KP-ja nuk ka repart të veçantë për trajtimin e tyre.

23. Po ashtu Raporti për Kosovën i vitit 2019¹⁵ thekson faktin se Kosova vazhdon të jetë një vend grumbullimi dhe transiti për heroinë dhe kanabis¹⁶. Sipas tij, në përgjithësi, konfiskimet e drogës mbeten të ulëta, andaj Kosova duhet ta intensifikojë edhe më tej identifikimin dhe shpërbërjen e grupeve të krimit të organizuar që trafikojnë drogë nga territori i saj ose përmes tij, si dhe t'i trajtojë të ardhurat nga krimi që shpëlahen në territorin e saj.

Instrumentet relevante ligjore

24. Kushtetuta në nenin 21, paragrafi 1, përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.”* Kurse paragrafi 2 i këtij neni thotë: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”*
25. Më tutje Kushtetuta në nenin 50 (Të drejtat e fëmijës) përcakton: *“1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. (...) secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.”* Kurse paragrafi 4 i këtij neni thotë: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërrmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”*
26. Kushtetuta në nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) përcakton: *“Te drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:(...) (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës. (...)”*
27. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: KDF), në nenin 1, përcakton: *“... me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare...”*
28. KDF-ja në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”*
29. Po ashtu, KDF-ja në neni 33 përcakton: *“Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legjislativë, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen në konventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.”*

¹⁵ <https://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>

¹⁶ Rreth 800 kilogramë marihuanë, 120 kg heroinë dhe 1 kg kokainë janë konfiskuar në vitin 2018.

30. Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Kodi)¹⁷, në kapitullin XXIII ka mbuluar këto vepra penale të narkotikëve: “*Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge (neni 267); Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike (neni 268); Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge (neni 269); Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope (neni 270); Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge (neni 271); Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit (neni 272); Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope (neni 273); Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull (neni 274); Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky Kapitull (neni 275); Kompensimi ndaj zbatuesve të ligjit (neni 276).*”
31. Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 02/L-128)¹⁸, pos tjerash, rregullon prodhimin, qarkullimin me shumicë dhe pakicë, importin, eksportin, kalimin transit, transportin, blerjen, furnizimin, shitjen, posedimin, konsumimin, përdorimin dhe propagandimin e bimëve prej të cilave mund të përfitohen narkotikët, barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët. Po ashtu ky ligj përcakton edhe obligimet e autoriteteve kompetente, të cilat kanë lidhshmëri me këto substanca.
32. Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: viti ii / NR. 12 / 01 MAJ 2007 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 02/L-17)¹⁹, në nenin 1, përcakton: “(...) Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak : (...) të varësisë nga alkooli ose drogat (...)”

Analiza ligjore

33. Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave, përfshirë edhe ato që parashohin mbrojtjen dhe kujdesin e domosdoshëm për mirëqenien e fëmijëve. Në këtë drejtim, Kushtetuta në nenin 21 shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, prandaj ky parim është domosdoshmëri i kohës dhe duhet respektuar nga të gjithë, përfshirë edhe rastet kur një fëmijë është përdorues i substancave narkotike.
34. Gjithashtu është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës ndërmarrja e veprimeve përkatëse nga institucionet shtetërore dhe joshtetërore për adresimin e këtyre rasteve.
35. Përcaktimet e Kushtetutës se fëmijët “gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre” dhe “të drejtën për të qenë të mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi”²⁰ vlejné edhe për çështjen që po e analizojmë, gjë që

¹⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

¹⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2572>

¹⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 50 (1.3)

përcaktojnë detyrime për institucionet shtetërore, përveç tjerash, që t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme në këtë drejtim. Nga të dhënat e siguruar nga policia del se shkollat në Kosovë përballen me pranimë e rasteve të përdorimit të substancave narkotike, gjë që kërkon edhe bashkëpunim dhe koordinim mes institucioneve arsimore dhe Policisë së Kosovës për adresimin adekuat të tyre. Mosadresimi i tyre paraqet shkelje të dispozitës kushtetuese në fjalë.

36. Adresimi përkatës nga institucionet shtetërore i rasteve të përdorimit të substancave narkotike duhet të bëhet në pajtim me interesin më të mirë të fëmijëve, ashtu siç është përcaktuar me Kushtetutë, përveç tjerash, edhe duke u ofruar atyre informacione adekuate dhe të plota për substancat narkotike, për ta parandaluar abuzimin me to dhe trajtim adekuat shëndetësor, si dhe rehabilitim dhe integrim të atyre që kanë krijuar varësi nga substancat narkotike.
37. Konsideratë mbizotëruese interesave më të mira të fëmijës i jep edhe KDF-ja, e cila në tërë tekstin e saj ngërthen reflektimin në drejtim të mbrojtjes së tyre. Konventa sipas Kushtetutës është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë. Prandaj çdo veprim i organeve shtetërore, në rastin konkret, për parandalim, për mbrojtje dhe për ndihmë fëmijëve, që janë vënë në pozitë të varësisë nga substancat narkotike, duhet të jetë në pajtim të plotë me qëllimin e Konventës. Shkelja eventuale e dispozitave të Konventës paraqet shkelje të Kushtetutës.
38. Në kuptim të pikës 27 të këtij Raporti, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë përfshirë në Kushtetutë dhe kanë përparësi zbatimi në rast konflikti, krahasuar me ligjet e tjera të zbatueshme vendore. Në pajtim me nenin 22 të Kushtetutës listohet, përveç tjerash, edhe KDF-ja.
39. Për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të fëmijëve, përfshirë këtu edhe të fëmijëve që janë vënë në pozitë të varësisë nga substancat narkotike, vlejné edhe dispozitat e tjera të KDF-së, të cilat mbulojnë segmente të ndryshme të jetës së fëmijës, duke u nisur nga kujdesi prindëror, e drejta në privatësi, mbrojtja nga çdo lloj abuzimi e deri te drejtësia për të mitur, përfshirë këtu edhe të drejtën për të përfutuar përkrahje shoqërore dhe masa të nevojshme, të cilat duhen respektuar dhe zbatuar me përpikëri nga institucionet publike, në rend të parë.
40. Për më tepër, neni 33 i KDF-së parasheh obligime për çdo shtet palë për t'i mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe i lëndëve psikotrope, dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve. Andaj, në frymën e këtyre dispozitave të KDF-së, institucionet shtetërore duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e duhura, qoftë "legjislative, administrative, shoqërore apo edukative, për t'i mbrojtur fëmijët në këtë aspekt"²¹.
41. Institucionet shtetërore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme lidhur çështjen në fjalë duhet që krahas neni 33 të KDF-së t'i kenë parasysh edhe dispozitat e tjera të KDF-së, që kanë të bëjnë me shpërndarjen e informacionit, mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e keqtrajtimit nga prindërit dhe kujdestarët e tjerë, shëndetin dhe

²¹ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1989, neni 33, në: [https://www.unicef.org/tfyr Macedonia/CRC_albanian_language_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfyr Macedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf). Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë dhe ka përparësi zbatimi krahasuar me aktet e tjera ligjore vendore në bazë të neni 22 të Kushtetutës.

shërbimet shëndetësore, edukimin për përgatitjen e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, mbrojtjen nga puna e rrezikshme ose shfrytëzuese, mbrojtja e fëmijëve të privuar nga liria dhe kujdesin rehabilitues,²² sepse ato janë në lidhje të ngushtë me të. Vetëm në këtë mënyrë fëmijëve do t'u ofrohet një ambient i sigurt për jetesë, shëndet dhe mirëqenie.

42. Fëmijëve përdorues të substancave narkotike duhet t'u ofrohet edhe përkujdesje sociale, shëndetësore dhe mbrojtje nga përjashtimi shoqëror, në pajtim me nenin 24 të KDF-së, i cili kërkon: *“Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfutuar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor. (...).”*
43. Në relacion me të drejtat, sipas KDF-së, gjatë punës së tyre me fëmijë, institucionet përkatëse shtetërore duhet t'i kenë parasysh edhe parimet, sipas të cilave, të drejtat e përcaktuara në Konventë duhet t'u njihen çdo fëmije, pa diskriminim në çfarëdo baze, interesit më të mirë të tyre duhet t'u jepet konsideratë primare në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, si dhe respektimit të së drejtës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, por edhe të pikëpamjeve të fëmijëve në të gjitha çështjet që ndikojnë tek fëmijët. Rrjedhimisht, institucionet e Republikës së Kosovës kanë për obligim që t'i ndërmarrin veprimet e duhura që fëmijët të jetojnë në një ambient i cili është i mbrojtur nga përdorimi dhe nga keqpërdorimi i substancave narkotike.
44. Çështjet të cilat lidhen me prodhimin, shitjen, posedimin e konsumimin e substancave narkotike, klasifikimin e tyre si dhe obligimet e autoriteteve kompetente rregullohen kryesisht me Ligjin nr. 02/L-128. Prandaj edhe mosrespektimi i tyre përbën shkelje të dispozitave të këtij ligji, përkatësisht të nenit 7. Rrjedhimisht mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, në pajtim me nenin 29, duhet ta bëjnë Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Doganat e Kosovës, secila në kuadër të fushëveprimit specifik, të përcaktuar me këtë ligj.
45. Përkitazi me çështjen, nga të dhënat e dërguara nga Policia e Kosovës, del se për një periudhë të caktuar kohore, përveç tjerash, janë arrestuar 710 persona, nga të cilët 150 kanë qenë fëmijë, gjë që është shqetësuese. Gjithashtu, sipas Policisë së Kosovës, brenda objekteve dhe oborreve shkollore si dhe në afërsi të tyre është konfiskuar një sasi e caktuar e marihuanës, gjë që po ashtu është shqetësuese dhe kërkon angazhim dhe vëmendje të shtuar të institucioneve përkatëse në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për vetëdijesim, parandalim, ndjekjen dhe dënimin e kryerësve me dënime meritore, në pajtim me Kodin, edhe për rastet e veprave penale të narkotikëve kur fëmijët janë shfrytëzuar apo veprat janë kryer në afërsi të shkollave apo të institucioneve edukative. Aq më tepër, varësisht nga rrethanat e rasteve, gjykata duhet ta vlerësojë dhe t'u shqiptojë masën e trajtimit me rehabilitim të detyrueshëm në institucionin e kujdesit shëndetësor atyre që kryejnë veprën penale nën ndikimin e drogës.²³

²² Shih nenet përkatëse në KDF-së, neni 17, 19, 24, 29, 32, 34, 35, 36, 37 dhe 39.

²³ Neni 87 i Kodit.

46. Gjithashtu, Kodi nr. 06/l-006 i Drejtësisë për të Mitur, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17 / 18 tetor 2018, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Kodi i Drejtësisë për të Mitur)²⁴, ka paraparë se gjykata mund të shqiptojë detyrim të veçantë ndaj të miturve për t'u përmbajtur nga përdorimi i drogës²⁵, si dhe rastet kur prokurori mund të shqiptojë masa të diversitetit sipas nenit 20²⁶, të cilat do të duhej të vlerësoheshin rast për rast në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës. Edhe Ligji nr. 02/L-17, i cili rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet në nevojë, e që i njeh si persona në nevojë edhe personat e varur nga droga dhe nga alkooli,²⁷ në rastin konkret fëmijët, gjithashtu duhet të vlerësohet dhe të zbatohet.
47. Pra, sipas këtij ligji, njerëzit - pra edhe fëmijët, të cilët kanë varësi nga alkooli dhe/apo drogat, definoohen si njerëz në nevojë, të cilët pa marrë parasysh statusin, natyrën dhe vendin e origjinës, duhet të pranojnë shërbime adekuate sociale nga qendrat për punë sociale, të cilat ofrojnë shërbime për shumë kategori të personave në nevojë, e që nuk i kanë mundësitë dhe kapacitetet e nevojshme për t'i mbuluar ato²⁸.
48. Republika e Kosovës deri më tani ka hartuar disa strategji dhe plane veprimi, të cilat janë të rëndësishme në këtë aspekt, siç janë: Strategjia shtetërore kundër narkotikëve dhe plani i veprimit për vitet 2018-2022, Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2017-2021, Strategjia kosovare për rininë 2013-2017 dhe Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë 2009 – 2018.
49. Strategjia shtetërore kundër narkotikëve ka paraparë arritjen e katër objektivave kryesore: reduktimin e kërkesës dhe zvogëlimin e dëmit, reduktimin e ofertës dhe furnizimit, bashkëpunimin e koordinimin dhe mbikëqyrjen e monitorimin.²⁹ Në kuadër të objektivës së parë për reduktimin e kërkesës dhe zvogëlimin e dëmit janë paraparë aktivitete specifike për parandalim, edukim, trajtim, rehabilitim, risocializim dhe riintegrim. Këtu duhet theksuar se strategjia parasheh hartimin dhe zbatimin e programeve shkollore për edukimin dhe vetëdijesimin e nxënësve për pasojat që sjell përdorimi i narkotikëve, hartimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese për shkaqet dhe pasojat e përdorimit të tyre, organizimin e debateve, fushatave informuese si dhe të takimeve me prindër.³⁰ Këto aktivitete është përcaktuar që të ndërmerren nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), nga Ministria e Shëndetësisë (MSh), nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe nga organizata joqeveritare (OJQ).
50. Ndërsa Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021, ndonëse rendit përdorimin e drogave si një ndër faktorët e rrezikimit të shëndetit të popullsisë³¹, nuk parasheh ndonjë aktivitet specifik që e adreson këtë faktor.

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18019>.

²⁵ Kodi nr. 06/l-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 28, paragrafi 2, nënparagrafi 2.8.

²⁶ Kodi nr. 06/l-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 20, paragrafi 1, nënparagrafi 1.15.

²⁷ Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 1.

²⁸ Informatat e siguruar nga QPS-të në takime të realizuara me ta në fund të vitit 2018 dhe fillimi i vitit 2019.

²⁹ Strategjia shtetërore kundër narkotikëve dhe plani i veprimit 2018-2022, Prishtinë, 2018, fq. 16.

³⁰ Po aty, fq. 20-23.

³¹ Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021, Prishtinë, 2016, fq. 20 në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-sektoriale-e-shendetesise-final-nentor-2016-ALB_.pdf.

51. Strategjia kosovare për rininë 2013-2017, në kuadër të edukimit dhe promovimit shëndetësor, ka paraparë vetëdijesimin e të rinjve për ndikimin dhe pasojat e përdorimit të substancave që shkaktojnë vartësi.³² Gjithashtu, Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë 2009 – 2018 synon organizimin e aktiviteteve edukative shëndetësore, siç janë fushatat informuese dhe trajnimet që kanë të bëjnë me problemet aktuale të të rinjve, ndër të tjera, edhe lidhur me drogat.³³
52. Sipas udhëzimit administrativ të MASHT-it: “Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme”, nxënësi i ndalohet bartja dhe konsumimi i drogës dhe i alkoolit në institucionet edukativo-arsimore.³⁴ Për më tepër, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019 për ndërprejen dhe ndalimin e punës së personit juridik dhe ndalimin e punës dhe inicimin e procedurës disiplinore të personit fizik, përkatësisht në nenin 6, paragrafi 1, përcakton: “1. Inspektorati i Arsimit e ndalon punën e mësimit dhe punëtorëve të tjerë të institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues si dhe inicimin e procedurës së masës disiplinore ndaj tyre nëse konstaton se:(...) 1.7 përdorë dhe shpërndan arme, drogë e gjëra të tjera të ndaluara me ligj; (...)”³⁵.
53. Për këto arsye, Avokati i Popullit, në pajtim me gjetjet e lartcekura, konstaton:
- Ekziston mungesë e qendrave të specializuara për trajtimin e të rinjve përdorues të substancave narkotike dhe mungesë e programeve përkatëse të vetëdijesimit dhe parandalues, si dhe mungesë e shërbimeve dhe trajtimit të përdoruesve të substancave narkotike, si për nga shtrirja gjeografike, ashtu edhe për nga cilësia;
 - ekziston mungesë e një baze unike kombëtare (gjithëpërfshirëse) e të dhënave statistikore, duke përfshirë mungesën e të dhënave të plota për shkaqet dhe llojin e substancave narkotike edhe për rastet e dyshimta të vdekjeve nga substancat narkotike;
 - ekziston mungesë e ekspertizës tek punonjësit e qendrave për punë sociale (në kuadër të mandatit të tyre ligjor) për t’u marrë me rastet e fëmijëve që përdorin substanca narkotike;
 - prezenca e substancave narkotike dhe konfiskimet e tjera nga Policia e Kosovës në afërsi të institucioneve edukative arsimore dhe fakti që shumë të rinj janë të përfshirë në aktivitete të lidhura me drogën është tregues i qartë se institucionet shtetërore duhet të bëjnë më shumë në parandalimin e përdorimit të substancave narkotike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në perspektivën afatgjatë të fëmijëve/ të të rinjve në Kosovë.
 - në bazën e të dhënave të KGJK-së dhe KPK-së ekziston mungesë e të dhënave që i referohen veprave specifike penale nga Kapitulli i XXIII i Kodit.

³² Strategjia kosovare për rininë 2013-2017, Prishtinë, 2013, fq. 22 në: https://www.mkrks-ks.org/repository/docs/strategjia_kosovare_per_rinine.pdf.

³³ Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë 2009 – 2018, Prishtinë, 2009, fq. 50, në: http://www.kryeministri.ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Shkollat_Promovuese_te_Shendetit_ne_Kosove_2009-2018.pdf.

³⁴ Udhëzim Administrativ 06/2014, neni 3, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10128>.

³⁵ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/05/ua-masht-04-19-x.pdf>.

54. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...).*” Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë

1. Krijimin dhe ofrimin e shërbimeve të veçanta të trajtimit dhe rehabilitimit të fëmijëve/ të rinjve (përdorues të substancave narkotike), duke përfshirë edhe mbështetjen e duhur familjeve të tyre.

Policisë së Kosovës

1. Identifikimin e hershëm të rreziqeve për abuzim me substanca narkotike nga fëmijët, profilizimin e grupeve kriminale si dhe krijimin e programeve parandaluese për mbrojtje nga rreziqet e përdorimit të substancave narkotike në shkolla dhe me popullsinë e gjerë.
2. Krijimin e një baze unike kombëtare (gjithëpërfshirëse) të të dhënave statistikore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shkaqet dhe llojin e substancave narkotike, për rastet e dyshimta të vdekjeve nga përdorimi i tyre.

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

1. Ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe financiare të punonjësve të shërbimeve sociale për të punuar me fëmijët të cilët janë në rrezik apo në varësi të substancave narkotike.

Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

1. Zhvillimin e aktiviteteve të vazhdueshme informuese me nxënësit dhe me prindërit, duke shpërndarë materiale dhe informacione të gjera rreth efekteve të dëmshme shëndetësore që vijnë nga përdorimi i substancave narkotike.
2. Organizimin e trajnimeve me mësimdhënës lidhur me identifikimin e hershëm të përdoruesve të substancave narkotike dhe pajisjen e tyre me materiale dhe informacione (module unike) rreth efekteve të dëmshme shëndetësore nga përdorimi i substancave narkotike.

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

1. Avancimin e bazës së të dhënave lidhur me vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me veprat penale specifike (*jo vetëm me nene*) nga Kapitulli XXIII i Kodit.


Këshillit Prokurorial të Kosovës

1. Avancimin e bazës së të dhënave lidhur me veprat penale specifike (*jo vetëm me nene*) nga Kapitulli XXIII i Kodit.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha*”

dokumentet dhe informacionet e kërkuara ne pajtim me ligj”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit